

VENDIM
Nr.853, datë 14.12.2011

**PËR LEJIMIN E BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË NËNSHKRUAR TË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË RRUGËVE DHE TË DREJTORIVE RAJONALE
RRUGORE NË QARQE SI AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e botimit të njoftimit të kontratës së nënshkruar të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe të drejtorive rajonale rrugore në qarqe, si autoritete kontraktore, brenda datës 20 dhjetor 2011, për objektet e caktuara sipas listave 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe drejtoritë rajonale rrugore në qarqe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA 1

Autoriteti kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve

1. Shërbim me roje civile (Behase, godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve).

LISTA 2

Autoriteti kontraktor: Drejtoritë rajonale rrugore në qarqe

I. Drejtoria Rajonale Rrugore, Shkodër:

1. Mirëmbajtje dimërore rruga Qafë Qele – Pukë (27.5 km);
2. Mirëmbajtje dimërore rruga Pukë - Qafë Mali (30 km);
3. Mirëmbajtje dimërore rruga Qafë Mali - Qafë Shllak (17 km).

II. Drejtoria Rajonale Rrugore, Dibër:

1. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore Skuraj - Burrel (40 km)+Ura e Ulzës-Ulëz (3 km);
2. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore Burrel - Qafë Buall (30 km);
3. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore Qafë Buall - Ura Topojanit (30 km);
4. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore Ura e Topojanit - Peshkopi (21 km) + Maqellarë - Doganë Bllatë (4 km);

5. Emergjencë;

6. Emergjencë (Blerje kripe).

III. Drejtoria Rajonale Rrugore, Kukës:

1. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore, aksi rrugor Kukës – Aeroport – Kolosjan - Dajç Reç (Peshkopi);
2. Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore, aksi rrugor Kam-Krumë.